



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL DURRËS**

Data____.____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Veshmbathje për punonjësit e A.P.D”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Veshjeve mbrojtëse dhe sigurie 35113400-3

Veshje 18300000-2

VLERA E FONDIT LIMIT:

6 774 573 (gjashtë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre) pa TVSH,

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar , nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Autoriteti Portual Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare. (2022,2023,2024), ku vlera e xhiros vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, nuk duhet të jetë më e vogël se 40% e vlerës përllogaritur të fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43 e 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, kerkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim,

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesi në procedurën e prokurimit publik bilancet e tre viteve të fundit 2022, 2023, 2024, të konfirmuara nga autoritetet përkatëse (organi tatimor), sipas parashikimeve ligjore në fuqi, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Ky kriter është i nevojshëm që Operatorët Ekonomik të paraqese dhe vertetoje vijueshmërinë e aktivitetit të Tij dhe zbatimin e ligjit si dhe të stabilitetit financiar të OE që do të kryej zbatimin e kësaj procedure furnizimi artikujsh për AK, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.2.3 Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesi në procedurën e prokurimit publik vërtetimin për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024, sipas vend ushtrimit të aktivitetit, të pasqyruar kjo në QKB. Ky kriter, duhet të plotësohet konform parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi, por që duhet të administrohet nga operatori ekonomik.

Argumentimi: Ky kriter është i nevojshëm që Operatorët Ekonomik të paraqese dhe vertetoje për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024, sipas vendit të ushtrimit të aktivitetit, të pasqyruar kjo në QKB për arsye që të jetë si aktivitet ekonomik në konform parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më pak se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brënda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e Operatorit Ekonomik ofertues në ofrimin e mallrave që janë objekt prokurimi në kontratë, pa vonesa dhe pengesa që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Kandidat/Operatori Ekonomik Ofertues, në rast se nuk është prodhues për të gjithë artikujt, objekt i kësaj procedure prokurimi, duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesit ose distributor i autorizuar, i cili merr përsipër të furnizojë Kandidatin me artikujt objekt prokurimi. Në rastin e distributorit të autorizuar, të paraqitet edhe dokumenti që vërteton lidhjen e distributorit të autorizuar me firmën prodhuese. (Autorizimi i prodhuesit duhet të përmbajë të dhënat të plota kontaktuese të prodhuesit si, telefon, email, website).

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, i garanton gjithashtu AK se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikëpamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë.

2.3.3 Operatorët ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë sipas standartit ISO 9001:2015 ose ekuivalente të lëshuara nga organet e pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë me standartet e kërkuara të cilësive dhe menaxhimit të mjedisit, me qëllim që të garantojë cilësinë e produkteve, të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituar nga DPA, ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Fusha e certifikimit, duhet të përkohet me kategoritë e produkteve që kërkohen të prokurohen.

Agrumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Gjithashtu kërkesa e mësipërme është e bazuar në kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë të OE i cili duhet të demonstrojë aftësinë e tij për të siguruar vazhdimisht produkte dhe shërbime që plotësojnë kërkesat e klientit dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore, si dhe të përfshijë proceset për përmirësimin e sistemit dhe sigurimin e konformitetit me klientin dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Të gjitha kërkesat e ISO 9001: 2015 janë të përgjithshme dhe kanë për qëllim të jenë të zbatueshme për çdo organizatë, pavarësisht nga lloji ose madhësia e saj, ose produktet dhe shërbimet që ofron.

2.3.4 Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues ose Prodhuesi, duhet të ketë në stafin e tij minimumi 8 punonjës, të vërtetuar këto me vërtetim mbi numrin e punonjësve, lëshuar nga administrata tatimore, si dhe listëpagesat dhe formularin E-SIG 025/a, të 3 muajve të fundit, të lëshuar nga organet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/ç), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa është e bazuar në përmbushjen e kushteve për plotësimin e numrit të punonjësve nisur nga sasia e artikujve të kërkuar si dhe mbi plotësimin e Formularit E-SIG 025/a.2 ”Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi”. Ky kriter është i nevojshëm që Operatorët pjesmarrës të provojnë besueshmërinë dhe provojnë e tyre në realizimin e kontratës pa vonesa dhe pengesa, që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3.5 Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues ose Prodhuesi, duhet të vërtetojë që zotëron në pronësi ose marrë me qira me kontratë të noterizuar, të paktën një makineri stampimi (shoqëruar me furrë tharjeje dhe presë pneumatike) dhe një makineri qëndisje. Pronësia e makinerive duhet të vërtetohet nëpërmjet paraqitjes së faturave të blerjes (përfshirë deklaratën doganore nëq është import) dhe inventarit të dorëzuar të tatimet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është e bazuar në specifikimet që kanë artikujt e veshmbathjes të cilat janë të stampuara me logo të A.P.D dhe F.S.P.D-së. Ky kriter është i nevojshëm që Operatorët pjesmarrës të provojnë besueshmërinë dhe provojnë e tyre në realizimin e kontratës pa vonesa dhe pengesa, që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK. Ky

kriter, duhet të plotësohet konform parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi, por që duhet të administrohet nga operatori ekonomik.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3.6 Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë çertifikatën OEKO-TEX® STANDARD 100, ose çertifikatë ekuivalente, e lëshuar në emër të tij ose të prodhuesit, për lëndën e parë të artikujve uniformave dhe artikujt bluzë pambuku me mëngë të shkurtra me tre kopsa dhe bluzë pambuku me mëngë të gjata.

Agrumentimi: Kërkesa e mëripërme është e bazuar në specifikimet që kanë artikujt e veshmbathjes të cilat janë të stampuara me logo të A.P.D dhe F.S.P.D-së. OEKO-TEX® STANDARD 100 është një **çertifikatë ndërkombëtare e sigurisë për tekstilet**, e cila garanton që produktet tekstile (pambuku, poliesteri, lëndë të ngjyrosura, etj.) **nuk përmbajnë kimikate të dëmshme për njeriun**, përfshirë:

- Formaldehid
- Pesticide
- Ngjyrues kancerogjenë
- Metalet e rënda

Kjo çertifikatë është **veçanërisht e rëndësishme për veshjet që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me lëkurën**, si uniformat, bluzat dhe veshjet sportive. Ky kriter, duhet të plotësohet konform parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi, por që duhet të administrohet nga operatori ekonomik.

2.3.7 Kandidati/Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikata të konformitetit për produktin final, të lëshuara në emër të tij ose të prodhuesit, të cilat vërtetojnë se mallrat objekt i kësaj procedure prokurimi – konkretisht veshjet e mirëmbajtjes– janë në përputhje me parametrat teknikë të përcaktuar në dokumentin e specifikimeve teknike, si dhe me standardet kombëtare/internacionale përkatëse ose ekuivalente, të njohura dhe të harmonizuara me Standardet Shqiptare (S.SH. EN).

1. Jelek fosforeshent me xhepa dhe zinxhir

- **S.SH. EN ISO 13688:2013** – Kërkesa të përgjithshme për veshje mbrojtëse
- **S.SH. EN ISO 20471:2013 + A1:2016, Klasa 1** – Veshje me dukshmëri të lartë

2. Këpucë pune dimërore

- **S.SH. EN ISO 20345:2011** – Këpucë mbrojtëse me majë çeliku dhe karakteristika të tjera mbrojtëse
- **Kategoria: S3 SRA/SRB/SRC FO SC**
 - **S3:** Hidroizolim, antistatik, rezistencë ndaj shpimeve, thembër e mbyllur

- **SRA/SRB/SRC:** Rezistencë ndaj rrëshqitjes
- **FO:** Rezistencë ndaj vajrave/hidrokarbureve
- **SC:** Rezistencë ndaj gërvishjeve dhe pastërtie të lehtë (scuff cap)

3. Bluze me mëngë të shkurtra

- **S.SH. EN ISO 13688:2013-** Kërkesa të përgjithshme për veshje mbrojtëse
- **S.SH. EN ISO 20471:2013 + A1:2016, Klasa 1-** Veshje me dukshmëri të lartë

4. Pantallona pune verore

- **S.SH. EN ISO 11612:2015** – Mbrojtje ndaj nxehtësisë dhe flakës:
 - A1, B1, C1, E3, F1
- **S.SH. EN ISO 11611:2015, A1, Klasa 1** – Mbrojtje për saldim
- **EN. IEC 61482-2:2018** – Mbrojtje nga rreziku i harkut elektrik
- **S.SH. EN 13034:2005 + A1:2009, Tipi 6** – Mbrojtje kundër kimikateve në spërkatje të lehtë
- **S.SH. EN 14325:2018** – Vlerësimi i performancës së materialeve për kimikate
- **S.SH. EN 1149-5:2018** – Veshje mbrojtëse antistatike

5. Xhup fosforeshent

- **S.SH. EN ISO 13688:2013-** Kërkesa të përgjithshme për veshje mbrojtëse
- **S.SH. EN ISO 20471:2013 + A1:2016, Klasa 3-** Veshje me dukshmëri të lartë
- **S.SH. EN 343:2019** Veshje mbrojtëse - Mbrojtja nga shiu
- **S.SH. EN ISO 4674-1:2016** Rezistente kunder grisjes
- **S.SH. EN ISO 811:2018** klasi 3 Rezistenca ndaj depërtimit të ujit
- **S.SH. EN ISO 1421:2016-** Fuqia dhe zgjatja e tekstilit
- **S.SH. EN ISO 13934-1:2013** Vetitë e pëlhurave në tërheqje
- **S.SH. EN ISO 5077:2007** Përcaktimi i ndryshimit në larje dhe në tharje
- **S.SH. EN ISO 11092:2014** rezistencën e djersitjes
- **S.SH. EN ISO 105-X12:2016** Qendrueshmeria e ngjyrës gjate ferkimit
- **S.SH. EN ISO 105-C06:2010** Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës gjatë larjes.
- **S.SH. EN ISO 105-E04:2013** Qendrueshmeria e ngjyrave gjate djersitjes
- **S.SH. EN 342:2017**
 - **0.303 m²·K/W (B)** – Izolim termik
 - **3 WP** – Rezistencë ndaj ujit, niveli 3

6. Jelek fosforeshent

- **S.SH. EN ISO 13688:2013-** Kërkesa të përgjithshme për veshje mbrojtëse
- **S.SH. EN ISO 20471:2013 + A1:2016, Klasa 2-** Veshje me dukshmëri të lartë
- **S.SH. EN ISO 105-X12:2016** Qendrueshmeria e ngjyrës gjate ferkimit
- **S.SH. EN ISO 105-C06:2010** Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës gjatë larjes.
- **S.SH. EN ISO 105-E04:2013** Qendrueshmeria e ngjyrave gjate djersitjes

7. Këpucë pune verore

- **S.SH. EN ISO 20345:2011** – Metodën e provës për këpucë sigurie

- **Kategoria: S1PL SRA/SRB/SRC ESD**
 - **S1PL:** Përfshin mbrojtje bazike + rezistencë ndaj shpimeve
 - **SRA/SRB/SRC:** Rezistencë ndaj rrëshqitjes
 - **ESD:** Mbrojtje nga elektriciteti statik
- **S.SH. EN 61340-5-1:2016** – Standard për mbrojtje elektrostатike në mjedise të ndjeshme

8. Kaska mbrojtëse

- **S.SH. EN 397:2012 + A1:2012** – Kaska për përdorim industrial
- **S.SH. EN 50365:2002** – Kaska për përdorim elektrik në rrjete me tension të ulët (deri 1000 V AC / 1500 V DC)

Argumentimi: Ky kriter është i domosdoshëm për të siguruar që Operatorët Ekonomikë, për të gjithë artikujt e kërkuar që lidhen me veshjet e Njesisë së Menaxhimit Detar, të paraqesin çertifikata të konformitetit për produktin final, të lëshuara në emër të tyre ose të prodhuesit. Këto çertifikata duhet të vërtetojnë përputhshmërinë me parametrat teknikë të përcaktuar në dokumentin e specifikimeve teknike, si dhe me standardet kombëtare/ ndërkombëtare përkatëse ose ekuivalente, të njohura nga Standardet Shqiptare (S.SH. EN), duke u bazuar në specifikat e punës që kryejnë personeli që do ti përdorë, kushtet e punës, siguria në punë etj. Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me kërkesën e mundshme nga KVO për vlerësimin e vërtetësisë së këtyre dokumentave mund të kontaktojë me prodhuesin ose organizmin çertifikues, të cilët duhet të kthejnë përgjigje dhe duhet të vënë në dispozicion dokumentat përkatëse, brenda një afati 3 ditor nga data e njoftimit të kërkesës.

Gjithashtu, të paraqitet deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ofertuese se, jemi dakort të bëhet verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në procedurën e prokurimit publik, pranë çdo institucioni/organi/kompanie që i ka lëshuar ato, në rast se do të lindin dyshime mbi dokumentacionin e paraqitur në procedurën e prokurimit publik.

2.3.8 Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë mostra për të gjithë artikujt e kësaj procedure prokurimi publik për të vërtetuar përputhshmërinë e tyre me përshkrimet fizike tek specifikimet teknike.

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të vlerësojë mallrat objekt procedure prokurimi nëse janë në përputhje me specifikimet teknike dhe gjykon se prezantimi i mostrave ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Kriteri i kërkuar në lidhje me paraqitjen e mostrave, është vendosur në përputhje me piken 6/a, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Sqarim: Mostrat e kerkuara te sillen nga Operatori ekonomik pjesemarres te paketuara ne zyren e protokollit te AK, deri ne daten dhe oren e mbylljes se tenderit dhe hapjes se ofertave. Mostrat do te jene te paketuara te protokolluara dhe ti drejtohen Komisionit te Vleresimit te Ofertave .

-Autoriteti Kontraktor ka te drejte te ekzaminoje secilen prej mostrave ne laboratore te Akredituar ne Republiken e Shqiperise ose nje laborator i Akredituar ne sferen Nderkombetare per te verifikuar perputhshmerine e treguesve teknike te tyre me skedat teknike korresponduese.

2.3.9 Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqese në tender një deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë mbi vendndodhjen e makinerive dhe pajisjeve të kërkuara, si për ato në pronësi, ashtu edhe për ato me qira, si dhe autorizon entin/autoritetin kontraktor të bëjë verifikimin fizik të tyre, me apo pa paralajmërim paraprak.

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të ketë mundësi të verifikojë fizikisht me apo pa paralajmërim vendndodhjen e makinerive dhe pajisjeve të kërkuara në pronësi apo me qera.

-AK ka te drejte te verifikojë secilen prej dokumentave me Institucionin qe i ka leshuar ato.

ARGUMENTIM MBI MARRËVESHJEN KUADËR :

1.Marrëveshja kuadër do të lidhet me një operator ekonomik, pasi janë të përcaktuara të gjitha kushtet kryesore të tilla si: lista e artikujve, specifikimet teknike, si dhe sasi të që pritet të furnizohen.

2. Nga përvoja e prokurimit të artikujve (objekt i kësaj procedure) në vite, çmimet e tregut kanë rezultuar të jenë të qëndrueshëm dhe nuk ndryshojnë.

3. Në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE, duke parë edhe natyrën e ketyre mallrave që pergjigjen nevojave imediate te AK kjo mund t'i shkaktonte kosto shtesë, pasiguri, dhe vështirësi autoritetit kontraktor, si p.sh. mospërputhje të artikujve të dhënë ne bazë te rendit, pjesë të tyre të përbashkëta.

1. Garancia e përdorimit 1 (një) vit.

2. Afati i lëvrimit do jetë **12 (dymbëdhjetë) muaj** nga data e nënshkrimit të marreveshjes kuadër.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë përshkruar saktë dhe në mënyrë të paanshme, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

KOMISIONI I PERCAKTIMIT TE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE

PERLLOGARITJES SE VLERES SE FONDIT LIMIT